UNIVERSITETI ”UKSHIN HOTI” PRIZREN
UNIVERSITY “UKSHIN HOTI” PRIZREN

# BULETINI

## I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË KONKURSIN Nr. 01-554 TË DATËS 09.11.2022 PËR RIEMËRIM / AVANCIM TË PERSONELIT AKADEMIK

Viti 2022

BULETINI Nr. 64 Dt. 14.12.2022

## III. FAKULTETI JURIDIK

1. **Një mësimdhënës sipas nenit 173 për lëndët:**
   - E drejta ndërkombëtare private (obligative) 6 orë;
   - E drejta e organizatave ndërkombëtare (obligative) 6 orë.

   Kandidat i paraqitur:
   **Ass. Shefki Shterbani**

2. **Një asistent (riemërim) sipas nenit 174 pika 1.3 për lëndët:**
   - E drejta doganore;
   - E drejta biznesore;
   - Mbrojtja e konsumatorit;
   - Financat dhe e drejta financiare (E drejta tatimore);
   - E drejta e ndërmarrjeve.

   Kandidat i paraqitur:
   **Ass. Simeana Beshi**

3. **Një asistent (riemërim) sipas nenit 174 pika 1.3 për lëndët:**
   - E drejta e procedurës civile I, pjesa kontestimore;
   - E drejta e procedurës civile II, pjesa jokontestimore;
   - E drejta familjare dhe trashëgimore.

   Kandidat i paraqitur:
   **Ass. Kastriote Vlahna**

4. **Një asistent (riemërim) sipas nenit 174 pika 1.3 për lëndët:**
   - E drejta kushtetuese I, pjesa e përgjithshme normative;
   - E drejta kushtetuese pozitive;
   - Teoria dhe praktika parlamentare.

   Kandidat i paraqitur:
   **Ass. Driola Susuri**

Universiteti i Prizrenit
Univerzitet u Prizrenu
Prizren Üniversitesi
"UKSHIN HOTI"
FAKULTETI JURIDIK
Pranuar me dt. 07.12.2022
Zyra e pranimit 410
Nr. i protokolit 03/322

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

*Adresa: Rr.Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren, Kosovë*

# RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIMIN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti: **Fakulteti Juridik**

Lënda/ët:

1. E Drejta Ndërkombëtare Private (obligative) 6 orë
2. E Drejta e Organizatave Ndërkombëtare (obligative) 6 orë

Kandidatët e paraqitur:

**Shefki Shtërbani**

Komisioni recensues:

1. **Prof. asoc. dr. Halim Bajraktari (Kryetar)**
2. **Prof. asoc. dr. Eqrem Zenelaj (Anëtar)**
3. **Prof. dr. Bekim Nuhija (Anëtar)**

Shënimet për kandidatin për të cilin shkruhet raporti:

| | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri: | Shefki Shtërbani |
| Datëlindja dhe vendlindja: | 11.05.1989- Rahovec |
| Shkollimi superior: | Dr. sc. |
| Grada shkencore: | Doktor i Shkencave Juridike- E Drejta Ndërkombëtare |
| Titujt akademikë: | Asistent (Ass.) |
| Viti kur është fituar titulli aktual: | 2015 |
| Departamenti/Fakulteti: | Fakulteti Juridik |
| Universiteti: | Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren |

Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti:

Profesor Asistent– **Prof. ass. dr.**

## 1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidatit:

**Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore**

| Veprimtaria shkencore e kandidatit | Prej fillimit të karrierës | Gjatë 4 vjetëve të fundit |
|---|---|---|
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor* | | 1 |
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor** | | |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor* | 1 | |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor** | | |
| Numri i publikimeve në konferenca ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor | | |
| Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon) | | |
| Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar) | | 1 |
| Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor | | 1 |
| Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore (të publikuara në Kosovë ose në rajon) si autor kryesor dhe si koautor | 4 | |
| Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja | | |
| Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe | | |
| Numri i librave ose monografive të botuara si koautor | | |
| Kontribute të tjera shkencore dhe artistike | | |

Vërejtje lidhur me tabelën 1:
***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.
****Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

## LIBRAT UNIVERSITARË

| Të dhënat për librin:<br>Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet | Linku i librit digjitale | Indeksimi ne platformat sipas udhëzimit të ministrisë |
|---|---|---|
| // | | |
| | | |

## MONOGRAFITË

| Të dhënat për monografinë:<br>Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet | Linku i monografis digjitale | Indeksimi ne platformat sipas udhëzimit të ministrisë |
|---|---|---|
| // | | |
| | | |

## Titujt profesional dhe shkencor

Punimet relevante të kandidatit

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen publikimet në revistat me "Impact factor")*

**Tabela 2. Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar**

| Të dhënat për punimet:<br>Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet | Web of Science | SCOPUS | EBSCO | WorldCat | DOAJ | "Impact factor" (pikët) | Pa "Impact factor" | Nr. i Citimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shefki Shtërbani, "*The Macedonia Name Dispute: ICJ's Decision and its Legal Approach*", Acta Universitatis Danubius, Juridica, Vol. 14, No. 1/2018. | | | √ | √ | √ | | | 7 |
| *Zhvillimi historik i normave për ndalimin e përdorimit të forcës nga ana e shteteve në të drejtën ndërkombëtare deri te Karta e OKB-së*". Revista: "Balkan Journal | | | | | | | √ | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| of Interdisciplinary Research". ISSN 2410-759X (print). Vol.1, No. 1, Maj 2015. | | | | | | | | |

| Pjesëmarrja dhe prezantimet në Konferenca Vendore dhe Ndërkombëtare | |
|---|---|
| Pjesëmarrës në konferencën ndërkombëtare me temën: *"20 Vite pas Ndërhyrjes së NATO-s në Jugosllavi: Aspekti Lokal, regjional dhe Global i 'Ndërhyrjes Humanitare'"*, organizuar nga Universiteti i Leipzigut- (Leibniz Institute for the History and Culture of Eastern Europe / GWZO), Leipzig, Gjermani 23-25 Maj 2019. | |
| Pjesëmarrës në konferencën ndërkombëtare me temën: *"Reformat në Drejtësi dhe Praktikat Anti- korrupsion: Sfidat, Perspektivat dhe Shkëmbimi i përvojave"* Pjesëmarrës në konferencën e parë ndërkombëtare për drejtësi dhe shkenca shoqërore, organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL) dhe Max Van der Stoel Research Institute, Tetovë, 30.06.2017. | |
| Pjesëmarrës në konferencën ndërkombëtare mbi temën: *"Shteti, Shoqëria dhe Ligji: Sfidat e Demokracisë dhe Qeverisjes së mire"* e organizuar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, 29.04.2017. | |
| Pjesëmarrës në konferencën ndërkombëtare për drejtësi, UBT, Durrës, 27-29 Tetor 2017 | |
| Pjesëmarrës në konferencën e pare studentore ndërkombëtare, organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL), Tetovë, 15 Prill 2017. | |

## 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

*1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, si dhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;*
*2. Me rastin e zgjedhjes/rizgjedhjes së asistenteve përparësi kanë kandidatët që vijojnë/kanë specializimin nga lëmia përkatëse ku konkurrojnë.*

Ass. Shefki Shtërbani ka filluar punën në Fakultetin Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren (UUHP), si asistent i angazhuar (bashkëpunëtor i jashtëm) në Shkurt të vitit 2015, në semestrin veror të vitit akademik 2014/2015, për një semestër (15.02.2015 -15.06.2015). Me vendim të Senatit të UUHP- së me nr. 01-419 të datës: 16.10.2015, kandidati ka marr thirrjen Akademike Asistent (Ass.) në Fakultetin Juridik të UUHP- së, për lëndët: E Drejta Ndërkombëtare Publike; Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut; E Drejta Ndërkombëtare Private; E Drejta Ndërkombëtare Humanitare; E Drejta Penale

Ndërkombëtare; E Drejta Diplomatike dhe Konsullore. Kandidati Ass. Shefki Shtërbani është rizgjedhur Asistent në vitin 2019 sipas Statutit të UUHP- së, përkatësisht Nenit 174, pika 1.3, për lëndët: E Drejta Ndërkombëtare Publike; Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut; E Drejta Ndërkombëtare Private dhe E Drejta Evropiane. Aktualisht Ass. Shefki Shtërbani vazhdon të mbajë pozitën e Asistentit të rizgjedhur për herë të dytë me vendimin e Senatit të UUHP- së, nr. 01-41, të datës: 10.02.2022, për lëndët: Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut; E Drejta Ndërkombëtare Publike; E Drejta Ndërkombëtare Private.

Gjatë këtyre viteve, Ass. Shefki Shtërbani ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në mësimdhënie, i njejti ka mbajtur ushtrime sipas akteve normative ne fuqi. Ass Shefki Shtërbani ka mbajtur edhe orë shtesë të ushtrimeve në Semestra të caktuar, si në lëndët:

E Drejta e Organizatave Ndërkombëtare, Arbitrazhi Tregtar Ndërkombëtar, Historia e Institucioneve Shtetërore dhe Juridike.

Gjatë vitit 2022 Ass. Shefki Shtërbani, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në organizimin e Shkollës Verore Ndërkombëtare, të Organizuar nga UUHP. Kandidati, ka organizuar dhe ka qenë bashkë- mentor në kursin e Fakultetit Juridik me titull: "Transitional Justice in Kosovo: The Persuit of Justice Throug Courts and Tribunals", duke ligjëruar për student të huaj dhe ata vendor, të cilët kanë qenë pjesëmarrës në këtë kurs të shkollës verore, nga 1- 12 Gusht 2022.

Përveç kontributit në mbajtjen e ushtrimeve të përcaktuara me vendime si Asistent në Fakultetin Juridik, Ass. Shefki Shtërbani po ashtu, ka ndihmuar Fakultetin Juridik në mbajtjen dhe organizimin e ligjëratave, vizitave studimore, në marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera dhe aktivitete të tjera shkencore të Organizuara nga Fakulteti Juridik i UUHP- së, pë aq kohë sa kandidati është pjesë e këtij Institucioni.

## 3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim`

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)*

Kandidati Ass. Shefki Shtërbani që nga fillimi i punës si Asistent në UUHP, nga 2015, ka kontribuar në aktivitete të ndryshme në shërbim të Fakultetit Juridik. Ass. Shefki Shtërbani, ka qenë Anëtar i Senatit në Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, duke përfaqësuar Fakultetin Juridik, nga data 08.03.2016- 30.09.2018. Kandidati, nga pozita e asistentit gjithashtu ka publikuar punime shkencore, ka marr pjesë në konferenca ndërkombëtare nga fusha e drejtësisë. Gjithashtu, kandidati ka qenë pjesë në aktivitete të ndryshme në Fakultetin Juridik, si në pjesëmarrje dhe organizim dhe aktivitete të fakultetit lidhur me ligjëratat, vizitat

studimore në fakultetin Juridik nga jashtë Universitetit, kontribut në procesin e akreditimit Institucional të UUHP- së dhe programit Baçelor të Fakultetit Juridik, pjesëmarrës në komisione të ndryshme në kuadër të Fakultetit dhe të Universitetit.
Ass. Shefki Shtërbani që nga viti 2021 është pjesë e Komisionit Qendror për Sigurimin e Cilësisë në nivel të Universitetit, duke kontribuar në procesin e sigurimit të cilësisë në Universitet. Kandidati ka një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin profesional, duke përfunduar tri cikle të trajnimeve për procesin e mësimdhënies dhe kështu pjesë e grupit të trajnerëve në kuadër të UUHP- së në kuadër të Qendrës për Përsosmëri në Mësimdhënie (QPM). Ass. Shefki Shtërbani, ka qenë po ashtu pjesë e mobilitetit për mësimdhënie si pjesë e programit ERASMUS+.

## 4. Mobiliteti i kandidatit

*(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka punuar/studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ai ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)*

Kandidati Ass. Shefki Shtërbani, ka përfunduar studimet themelore **Jurist i Diplomuar-Baçelor** në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, në vitin 2012. Studimet Master i ka përfunduar në vitin 2014 në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë, me titullin **LL.M. (Master) në të Drejtën Ndërkombëtare**. Ndërsa studimet e doktoratës ka regjistruar në vitin akademik 2015/16 në Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL), në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe ka përfunduar ato në vitin 2021, ku mori gradën shkencore **DOKTOR I SHKENCAVE JURIDIKE- E Drejta Ndërkombëtare.**
Ass. Shefki Shtërbani ka marr pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare, të organizuara nga Universitete në rajon dhe në Evropë. Duke përfshirë vizitat studimore në Universitete në rajon dhe në vende të tjera. Po ashtu, Ass. Shefki Shtërbani, në Tetor të vitit 2022, ka qenë pjesë e Mobilitit në kuadër të ERASMUS+ si pjesë e stafit akademik në mësimdhënie, në Universitetin 'Sivas Cumhuriyet Üniversitesi', Turqi.

## 5. Mentorimi i temave Master dhe Doktorates

| Emri dhe mbiemri i kandidatit | Viti / Niveli i studimeve | Data e regjistrimit të lejimit të punimit | Në proces | Data e përfundimit |
|---|---|---|---|---|
| // | | | | |

## 6. Titulli i cili propozohet

*(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në statut dhe në Konkurs dhe përse Kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjerët që të propozohet).*

Sipas konkursit, 01- 554, datë: 09.11.2022, duke u mbështetur në Statutin e Universitetit Ukshin Hoti" Prizren, neni 173, dhe Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik, në Universitetin "Ukshin Hoti", neni 6, Komisioni Recensues paraqet këtë:

**PROPOZIM**

Në bazë të dhënave dhe të aktiviteteve shkencore, akademike dhe profesionale, të paraqitura në këtë raport recensues, Komisioni recensues në mënyrë unanime i propozon Këshillit të Fakultetit Juridik dhe Senatit të UUHP- së, që kandidati **Ass. Shefki Shtërbani, i plotëson kriteret formale dhe juridike të zgjedhet në pozitën Profesor Asistent (Prof.Ass.Dr.), për lëndët 1.E Drejta Ndërkombëtare Private** dhe **2. E Drejta e Organizatave Ndërkombëtare.**

**ARSYETIM**

Në bazë të konkursit të datës: 09.11.2022, me nr. 01- 554, UUHP ka hapur konkurs për pozitën profesor asistent për lëndët: 1. E Drejta Ndërkombëtare Private dhe 2. E Drejta e Organizatave Ndërkombëtare. Pas propozimit nga Fakulteti Juridik për caktimin e komisionit recensues, me vendim të Senatit të UUHP me nr. 01- 587, Komisioni recensues për vlerësimin e dokumentacionit për aplikant në konkursin e përmendur më lartë, përbëhet nga Prof.asoc.dr. Halim Bajraktari (kryetar), Prof.asoc.dr. Eqrem Zenelaj (anëtar) dhe Prof.dr. Bekim Nuhija (anëtar). Komisioni recensues, ka pranuar aplikimin e kandidatit të vetëm për këtë pozitë, Ass. Shefki Shtërbani dhe ka trajtuar me kujdes të gjithë dokumentacionin e paraqitur pranë Komisionit. Pas shqyrtimin të aplikimit për pozitën prof.ass.dr., për lëndët e përmendura më lartë, Komisioni konsideron se Ass Shefki Shtërbani, i plotëson të gjitha kriteret formale dhe juridike, të përcaktuara sipas Statutit të Universitetit Ukshin Hoti" Prizren, neni 173, dhe Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik, në Universitetin "Ukshin Hoti", neni 6 për pozitën prof.ass.dr., për lëndët e paraqitura në këtë recension.

Komisioni konsideron se kandidati Ass. Shefki Shtërbani, i plotëson të gjitha kriteret të cilat janë të përcaktuara, për këtë pozitë. Ass. Shefki Shtërbani, ka gradën shkencore në fushën e së drejtës ndërkombëtare, në përputhje me lëndët e paraqitura në këtë Konkurs. Kandidati, po ashtu ka përvojën e mjaftueshme dhe aftësi në mësimdhënie, ka paraqitur publikime shkencore dhe konferenca ndërkombëtare, ashtu siç janë të paraqitura në këtë recension.
Prandaj, Komisioni nga ajo që u pasqyrua më lartë në mënyrë unanime i propozon Këshillit të Fakultetit Juridik dhe Senatit të UUHP- së, se kandidati Shefki Shtërbani i plotëson të gjitha kriteret të përcaktuara me nenin 173, Statutit të UUHP- së dhe nenit 6, të Rregullores për Procedurat e Përzgjedhjes lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik, të zgjidhet në pozitën profesor asistent, në lëndët 1. E Drejta Ndërkombëtare Private dhe 2. E Drejta e Organizatave Ndërkombëtare.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e komisionit recensues:

1. ________________ **Prof.asoc.dr. Halim Bajraktari (Kryetar)**

2. ________________ **Prof.asoc.dr. Eqrem Zenelaj (Anëtar)**

3. ________________ **Prof.dr. Bekim Nuhija (Anëtar)**

Prizren, Dhjetor 2022

Universiteti i Prizrenit
Univerzitet Prizrena
Prizren Üniversitesi
"UKSHIN HOTI"
FAKULTETI JURIDIK
Pranuar me dt. 07.12.2022
Zyra e pranimit 410 | Nr. i protokolit 05/524

**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

*Adresa: Rr. Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren, Kosovë*

# RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES
# PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIMIN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti: *Juridik*

Lënda/ët:

- E Drejta Doganore;
- E Drejta Biznesore;
- Mbrojtja e Konsumatorit;
- Financat dhe e Drejta Financiare (E Drejta Tatimore)
- E Drejta e Ndërmarrjeve.

Kandidatët e paraqitur:

*Ass. Simeana Beshi PhD C*

Komisioni recensues:

Komisioni recensues sipas vendimit të Senatit nr. 01-595 të datës 23.11.2022 ka këtë përbërje:

1. Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi- kryetar;
2. Prof. Asoc. Dr. Armend Podvorica- anëtar;
3. Prof. Ass. Dr. Luan Vardari- anëtar.

Shënimet për kandidatin për të cilin shkruhet raporti:

| | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri: | Simeana Beshi |
| Datëlindja dhe vendlindja: | 15.05.1991, Prizren |
| Shkollimi superior: | PhD Kandidat |
| Grada shkencore: | LL.M. në të Drejtën Financiare<br>M.A. në Juridik dhe Menaxhimin e Patundshmërive dhe Infrastrukturës |
| Titulljt akademikë: | Asistent |
| Viti kur është fituar titulli aktual: | 2019 |
| Departamenti/Fakulteti: | Juridik |
| Universiteti: | "Ukshin Hoti" Prizren |

Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti: Ass.

## 1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidatit:

**Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore**

| Veprimtaria shkencore e kandidatit | Prej fillimit të karrierës | Gjatë 4 vjetëve të fundit |
|---|---|---|
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor* | 3 | / |
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor** | / | / |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor* | 1 | 1 |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor** | / | / |
| Numri i publikimeve në konferenca, (kongrese dhe simpoziume) ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor | 10 | 4 |
| Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon) | 3 | 1 |
| Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar) | / | / |
| Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor | 1 | 1 |
| Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore (të publikuara në Kosovë ose në rajon) si autor kryesor dhe si koautor | 1 | 1 |
| Kontribute të tjera shkencore dhe artistike | 21 | 2 |

Vërejtje lidhur me tabelën 1:
***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.
****Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

## Titujt profesional dhe shkencor

Punimet relevante të kandidatit

**Tabela 2. Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar**

| Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet | Web of Science | SCOPUS | EBSCO | WorldCat | DOAJ | "Impact factor" (pikët) | Pa "Impact factor" | Nr. i Citimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Beshi, S.**, Value Added Tax Harmonization- A Discussions on the Legal and Financial VAT Aspects in the EU States and the Case of Kosovo/ Journal of Legal, Ethical and Regulatory Issues/ 2022/Vol 25/4S/ 1-14/ [link] | | | | X | | | | |
| **Beshi, S.**, Arbitrage and the Arbitration Procedure/ European Academic Research/ 2016 / Vol. IV, Issue 8/ November/ 7093-7106/ [link] | | | | X | X | 3.4546 (UIF) | | |
| **Beshi, S.**, Krasniqi, S. Kosovo Fiscal System and Policy under the UNMIK Administration until the Formation of State of Kosovo/ European Academic Research/ 2016 / Vol. III, Issue 11/ 11988- 11996/ [link] | | | | X | X | 3.4546 (UIF) | | |
| **Beshi, S.**, New Amendments To Fiscal Package Tax Legislation In Kosovo/ American Resarch Thoughts/2016/Volume 2, Issue 5/ 3662 | | | | X | X | 2.0173 (UIF) | | |
| **Beshi, S.** Value Added Tax As Theory And Practice In The Tax System In The Republic Of Kosovo And Efforts For Harmonization/ Economics, Business and Social Sciences/Verlag SWG imex GmbH/ Nuremberg/ Germany/2020/86-94/ [link] | | | | | | | | |

**Tabela 3. Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel kombëtar**

| Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet | Web of Science | SCOPUS | EBSCO | WorldCat | DOAJ | "Impact factor" (pikët) | Pa "Impact factor" | Nr. i Citimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Beshi, S., The harmonized European Value Added Tax System and the Case of Kosova/ South East European Journal of Sustainable Development/ 2021 Vol 5 2/ 50-58/ [link] | | | X | | | | | |
| Beshi, S., Krasniqi, S. Amendments to the Law on Value Added Tax in Kosovo/ Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences/ 2016 / Vol. 2, No. 1 March/ 259-264/ [link] | | | X | X | | | | |
| Beshi, S., Evazioni Fiskal- si efekt i papërshtatshëm i tatimit ndaj obliguesve tatimor dhe format e paraqitjes së tij/ Balkan Journal of Interdisciplinary Research/2016/ Vol. 2, No. 1 May/ 243-249 [link] | | | | | | | | |
| Riza, A., Beshi, S., Tax harmonization in the european union/ Interdisiplinary Journal of Research and Development/ 2015/ 4 (1) / 7-13/ [link] | | | X | | | | | |
| Beshi, S., Konkurrenca në Tatimin e Korporatave brenda Komunitetit Evropian dhe në të drejtën e Komunitetit Evropian/ Reforma/ 2017/Nr. 5/2017/ 151/ | | | | | | | | |
| Krasniqi S., Beshi, S., Interpretimi i konventave ndërkombëtare me theks të veçantë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut/ 2016/ Nr. 3/2016/ 302 / | | | | | | | | |
| Beshi, S., Analizë e shkurtër rreth ndikimit të pandemisë COVID-19 në buxhet/ Revistë Juridiko-Sociale "JUSTINIANI I"/ 2020/ 1/ 16-26/ [link] | | | | | | | | |
| Beshi, S., Buxheti dhe roli i parlamentit në procedurën | | | | | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| buxhetore me këndvështrim të posaçëm në Kosovë/ Revistë Juridiko-Sociale "JUSTINIANI II"/ 2019/ 1/ 82-100 [link] | | | | | | | | |

**Tabela 4. Publikime në kapituj librash ose të arriturat artistike të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar**

| **Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Libri / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet** | Web of Science | SCOPUS | EBSCO | WorldCat | DOAJ | "Impact factor" (pikët) | Pa "Impact factor" | Nr. i Citimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Beshi, S.**, Cryptocurrency Awareness in Kosovo/ New Approaches to CSR, Sustainability and Accountability, Volume III/ 2022 / 81-100/ [link] | | X | | | | | | |
| **Beshi, S.**, Property Inheritance by Women in Kosovo/ 2020/ New Approaches to CSR, Sustainability and Accountability, Volume I/ 159-17/ [link] | | X | | | | | | |
| **Beshi, S.**, Braha, F., The impact of the globalization process in Transforming traditional banking into the Modern banking/ 2018/ 76-119 / | | | | X | | | | |
| Braha, F., **Beshi, S.**, Cryptocurrencies as a new world trend, and Their impact on financial markets/ 2018/ 120-156/ | | | | X | | | | |

## 2. Përvoja në mësimdhënie universitare

Ass. Simeana Beshi, ka një përvojë të gjatë dhe të shkëlqyeshme në mësimdhënie. Përvojat e para akademike i filloi si asistente e pastaj si ligjëruese në Kolegjin "FAMA", në Prizren, Prishtinë, Gjilan dhe Mitrovicë në vitet 2015-2019, në lëndët: "Financat dhe e Drejta Financiare", "E Drejta e Punës", "Interpretimi dhe referimi i normave juridike".

Më tej, në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren ka themeluar marrëdhënie pune që nga viti 2016 si asistente e angazhuar në lëndët: "Hyrje në ekonomi", "E Drejta e Falimentimit", "E Drejta Biznesore", "E Drejta Doganore", "E Drejta Bankare".

Po ashtu, në semestrin veror të vitit akademik 2017/18, në pozitën e asistentes, ka qenë e angazhuar edhe në programin Master i Përbashkët në Fakultetin Juridik në drejtimin *"Qeverisja lolake dhe shoqëria demokratike"* i themeluar nga tre Universitete, konkretisht, Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren dhe Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në lëndën: "Prokurimi dhe Transparenca".

Në thirrjen akademike *Asistent* është zgjedhur me datë 1 Tetor 2019 në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren në lëndët: "E Drejta Doganore", "E Drejta Biznesore", "Mbrojtja e Konsumatorit", "Financat dhe e Drejta Financiare (E Drejta Tatimore)" dhe "E Drejta e Ndërmarrjeve".

Duke u bazuar në përvojën e saj si asistente dhe ligjëruese vlerësohet se ka treguar aftësi të larta akademike dhe njëherit është angazhuar me përkushtim maksimal në përmbushjen e detyrave si mësimdhënëse në raport me studentët. Puna e saj është vlerësuar me sukses të shkëlqyeshëm nga studentët.

### 3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim`

Ass. Simeana Beshi ishte e angazhuar në pozita menaxheriale në Fakultetin Juridik, të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren dhe atë në cilësinë e Shefes për Mësim me çka vlerësohet se ka dhënë kontribut të madh në procesin mësimor dhe në zhvillimin dhe avancimin e Fakultetit Juridik.

Njëherit nga viti 2019-2022 ka qenë edhe Kryeredaktore e revistës juridiko-sociale "Justiniani II" në Fakultetin Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren. Po ashtu, është angazhuar edhe si anëtare në komisione të ndryshme në nivel të fakultetit si: Komisionit Vlerësues për pranimin e studentëve në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, Komisionit të Ankesave për pranimin e studentëve në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren.

Duhet theksuar se ka qenë mjaft aktive me pjesëmarrje në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, kongrese e simpoziume. Këtu veçojmë disa prej tyre si: "International Online Conference on Economics & Social Sciences, Lahore, Pakistan", 2021; "Eurasian Conference on Language & Social Science, Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", Gjakovë", 2021; "Economics, Business and Social Sciences, Verlag SWG imex GmbH, Nuremberg, Germany", 2020; "4th TDS Conference, "Mother Teresa" University Skopje, Macedonia", 2020; "International CEO (Communication, Economics, Organization) Social Sciences Congress, Gorajde, Bosnia Herzegovina", 2020; "IV. International Conference: The West of the East, The East of the West / Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, Prizren, Kosovo", 2019, e shumë konferenca të tjera ndër vite.

**4. Mobiliteti i kandidatit**

- Simeana Beshi, u lind më 15 Maj 1991 në Prizren, ku edhe ka përfunduar shkollën fillore dhe të mesme.
- **Simeana Beshi** ka të përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në Prishtinë ku mori titullin **Jurist i diplomuar- Bachelor**.
- Studimet Master i përfundoi në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" ku mori titullin: **LL.M. në të Drejtën Financiare.**
- Studimet e Masterit të dytë i përfundoi në Kolegjin ESLG, ku mori titullin: **M.A. në Juridik dhe Menaxhim i Patundshmërive dhe Infrastrukturës.**
- Aktualisht është në përfundim të studimeve të Doktoraturës në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Juridik, Programi Financiar.
- Ajo ishte studente e shkëlqyer në të gjitha nivelet e studimeve të saja si dhe studente bursiste.
- Poashtu ka qenë pjesëmarrëse në konferenca, trajnime dhe punëtori kryesisht nga fusha e drejtësisë dhe financave, të cilat i ka dëshmuar përmes çertifikatave.

Simeana Beshi në vitin 2016/17 është angazhuar si asistente në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", në lëndët juridiko-financiare sikurse janë: E Drejta Doganore, Financat dhe e Drejta Financiare, E Drejta Bizesore, E Drejta e Falimentimit, Hyrje në Ekonomi, Mbrojtja e Konsumatorit, E Drejta e Ndërmarrjeve, Prokurimi dhe Transparenca në nivelin Master.

Gjatë kësaj periudhe kandidatja me angazhimin e saj ka treguar profesionalizëm dhe përgjegjësi në kryerjen e detyrave të asistentes. Njëherësh të sipër përmendurën e karakterizuan edhe aftësitë e mira të organizimit dhe menaxhimit, fleksibiliteti në punë ekipore, aftësitë për të punuar brenda afateve dhe kufizimeve të caktuara, aftësitë për t'i dhënë zgjidhje problemeve në situata të ndryshme, si dhe nuk ka refuzuar asnjë lloj pune që i është besuar asaj, duke u treguar e gatshme për bashkëpunim në çdo moment. Kandidatja, u dallua edhe nga aftësitë analitike dhe shkathtësitë oratorike në komunikimin juridik. Më tej, Simeana Beshi ka pasur sjellje korrekte me stafin dhe studentët çka dëshmohet edhe nga raporti i vlerësimit i Komisionit për Sigurimin e Cilësisë të Fakultetit Juridik. Gjatë procesit mësimor dhe pedagogjik ka reflektuar pozitivisht si personalitet me integritet njerëzor, shkencor dhe intelektual. Rizgjedhja e saj si asistente e rregullt është komplementare me ngritjen e cilësisë së studimeve në Fakultetin Juridik e cila njëherit përkon me përvojën dhe përgatitjen e saj. Poashtu, kandidatja ka punuar si asistente dhe ligjëruese në Kolegjin FAMA në lëndët Juridiko-Financiare, nga data 01.11.2015- 31.05.2019.

**5. Titulli i cili propozohet: Asistent**

PROPOZIM

Komisioni recensues pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar të kandidates Ass. Simeana Beshi dhe kritereve të përcaktuara për rizgjedhjen në thirrjen Asistent në Fakultetin Juridik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, ka nderin dhe privilegjin që ***në mënyrë unanime t'i propozojë Këshillit të Fakultetit Juridik dhe Senatit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, kandidaten Ass. Simeana Beshi që të rizgjedhet në thirrjen akademike Asistent për lëndët e shpallura në konkursin* nr. 01-554 të datës 09.11.2022, *në lëndët:* E Drejta Doganore, E Drejta Biznesore, Mbrojtja e Konsumatorit, Financat dhe e Drejta Financiare (E Drejta Tatimore), E Drejta e Ndërmarrjeve.**

ARSYETIM

Duke u mbështetur në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren nr. 04-V-621 të datë 30 Maj 2013, Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren nr. 01-161 të datës 29.07.2020 dhe në kriteret e përcaktuar në konkursin për emërim, riemërim, avancim të personelit akademik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren nr. 01-554 të datës 9.11.2022 dhe dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë, komisioni recensues pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar vlerëson se kandidatja Ass. Simeana Beshi ka plotësuar të gjitha kriteret për t'u rizgjedhur në thirrjen akademike Asistent për lëndët: E Drejta Doganore, E Drejta Biznesore, Mbrojtja e Konsumatorit, Financat dhe e Drejta Financiare (E Drejta Tatimore), E Drejta e Ndërmarrjeve.

Më konkretisht, Komisioni analizoi veprimtarinë e tërësishme shkencore dhe akademike të kandidates, me ç'rast konstatoi se kandidatja posedon përgatitje arsimore, shkencore dhe profesionale (në Bachelor, Master dhe Phd në lëmin juridiko-financiar), pikërisht në lëndët për të cilat është shpallur konkursi, ka përvojë shtatë vjeçare në mësimdhënie, ka të publikuara mjaftueshëm punime shkencore në revista shkencore rajonale dhe ndërkombëtare të indexuara në SCOPUS dhe platforma tjera, është pjesëmarrëse në konferenca, kongrese dhe simpoziome shkencore ndërkombëtare, etj.

Kandidatja ka treguar rezultate të shkelqyeshme gjatë studimeve themelore, në master dhe vazhdon me suksese të shkëlqyera studimet e doktoranturës.
Kandidatja Ass. Simeana Beshi njeh në të shkruar dhe në të folur gjuhen angleze dhe turke.
Të gjitha këto kritere të plotësuara janë elaboruar gjerësisht në pjesët e mësipërme të këtij raporti.
Andaj, ne si Komision fuqishëm i propozojmë Këshillit Mësimor/Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" rizgjedhjen e Ass. Simeana Beshi Phd Kandidate, në cilësinë e Asistentes në Fakultetin Juridik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, për lëndët e shpallura në konkursin e lartcekur pasi që i plotëson të gjitha kriteret formale, shkencore, akademike dhe njerëzore për rizgjedhjen në thirrjen akademike Asistent.

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e komisionit recensues:

1. ______________________ **Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi – Kryetar**

2. ______________________ **Prof. Asoc. Dr. Armend Podvorica – Anëtar**

3. ______________________ **Prof. Ass. Dr. Luan Vardari – Anëtar**

Prizren, Nëntor 2022

Universiteti i Prizrenit
Univerziteti u Prizrenu
Prizren Üniversitesi
"UKSHIN HOTI"
FAKULTETI JURIDIK
Pranuar me dt. 07.12.2022
Zyra e pranimit 410
Nr. i protokolit 03/323

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

*Adresa: Rr.Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren, Kosové*

# RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIMIN E STAFIT AKADEMIK

**Fakulteti: Fakulteti Juridik**

**Lënda/ët:**

1. **E drejta e procedurës civile I, pjesa kontestimore;**
2. **E drejtae procedurës civile II, pjesa jokontestimore;**
3. **E drejta familjare dhe trashëgimore**

**Kandidatët e paraqitur:**

1. **Ass. Phd.C. Jur. Kastriote Vlahna. LL.M.**

**Komisioni recensues:**

Raporti është shkruar nga komisioni recensues i cili është themeluar me vendim të Senatit të Universitetit të Prizrenit " Ukshin Hoti" nr/01-358, të datës 18.11.2021, për hartimin e raporteve për vlerësimin e kandidateve te cilët janë paraqitur ne konkurs për emërimin/ riemërimin dhe avancimin e personelit Akademik për lëndët:

1. **E drejta e procedurës civile I, pjesa kontestimore;**
2. **E drejta e procedurës civile II, pjesa jokontestimore;**
3. **E drejta familjare dhe trashëgimore.**

Sipas vendimit të Senatit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", nr/01-594, datë 23.11.2022, komisioni është në përbërje:

**1. Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi - Kryetar**

**2. Prof. Asoc. Dr. Enver Buqaj - Anëtar**

**3. Prof. Asoc. Dr. Armend Podvorica - Anëtar**

**Shënimet për kandidatin për të cilin shkruhet raporti:**

**Kandidati 1**

| | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri: | **Kastriote Vlahna** |
| Datëlindja dhe vendlindja: | 30.09.1991 |
| Shkollimi superior: | Studime të Masterit |
| Grada shkencore: | Magjistër/e e shkencës Juridiko-Civile |
| Titujt akademikë: | Ass. (Asistent/e e rregullt) |
| Viti kur është fituar titulli aktual: | 2019 |
| Departamenti/ Fakulteti: | Juridik |
| Universiteti: | Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" |

**Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti:**

Ass. (Asistent/e e rregullt)

**1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor**

Kontributi shkencor i kandidatit:

**Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore**

| Veprimtaria shkencore e kandidatit | Prej fillimit të karrierës | Gjatë 4 vjetëve të fundit |
|---|---|---|
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor* | 5 | 2 |
| Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor** | 20 | 20 |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor* | 2 | 2 |
| Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor** | 2 | 2 |

| | | |
|---|---|---|
| Numri i publikimeve në konferenca ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor | 43 | 43 |
| Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon) | 25 | 25 |
| Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar) | 5 | 5 |
| Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor | 36 | 36 |
| Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore (të publikuara në Kosovë ose në rajon) si autor kryesor dhe si koautor | 7 | 7 |
| Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja | 0 | 0 |
| Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe | 0 | 0 |
| Numri i librave ose monografive të botuara si koautor | 0 | 0 |
| Kontribute të tjera shkencore dhe artistike | 6 | 6 |

**Titujt profesional dhe shkencor**

**Punimet relevante të kandidat/es**

**Tabela 2. Punimet shkencore ose të arriturat artistike të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar**

| Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Viti / Vëllimi / Numri / Faqet | Web of Science | SCOPUS | EBSCO | World Cat | DOAJ | "Impact fa | Pa "Impact factor | Nr. i Citimeve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | ct<br>or<br>"<br>(p<br>ik<br>ët<br>) | " | |
| Punimi si autor i parë: **Phd.C. Kastriote Vlahna / Prof. Dr. Hajredin Kuçi;**<br>**Titulli i punimit:** Winner prescription as a way of gaining the right of real servitude according to the legislation in Kosovo with a some European countries.<br>**Publication:** Looking for New Paths in Comparative and International Law. June 25, 2021, Bucharest.Volume: 3;<br>Issue: ISBN 978-606-95351-0-3 (E-Book);<br>Pages:58.<br>**Index:** **Web of Sciens,** Ebsco, WorldCat, Doaj, Index Copernicus, HeinOnline.<br>**Scientific journal link:**<br>http://www.adjuris.ro/reviste/lnpci/Looking%20for%20New%20Paths%20in%20Comparative%20and%20International%20Law.pdf | PO | | PO | PO | PO | 3 | | PO |
| Punimi si autor i parë: **Phd.C. Kastriote Vlahna / Prof. Dr. Hajredin Kuçi;**<br>**Titulli i punimit:**<br>The Creation of the Right of Real Servitude: Derivative and Original Method Based on the Kosovo and Some European Countries<br>**Publication:**<br>Hasanuddin Law Review; ISSN: 2442-9880 \| e-ISSN: 2442-9899; Publication date: 2022/7/30; Volume: 8; Issue: 2; Pages: 111-121.<br>**Index: Scopus,** Ebsco, Doaj, WordCat, google solar, etc.<br>**Scientific journal link:**<br>http://pasca.unhas.ac.id/ojs/index.php/halrev/issue/view/144<br>**Viev Article:**<br>http://pasca.unhas.ac.id/ojs/index.php/halrev/article/view/3614/837 | | P<br>O | PO | PO | PO | 1 | | PO |
| Punimi si autor i parë: **Phd.C. Kastriote Vlahna / Prof. Dr. Hajredin Kuçi;**<br>**Titulli i punimit:**<br>Property rights with special emphasis on the right of servitude according to the legislation in Kosovo with a comparative view with some European countries.<br>**Publication:** | | P<br>O | PO | PO | PO | | 1 | PO |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Review of International Geographical Education Online.<br>**ISSN: 2146- 0353;** Publication date: Viti: 2021/6/23; Volume: 11; Issue: 8; Pages: 1761-1769;<br>**Index: Scopus,**<br>Ebsco, Eric, Index Copernicus, Informit I.<br>**Scientific journal link:**<br>https://simdos.unud.ac.id/uploads/file_penelitian_1_dir/053e7675746265ac19f50ed15d13995b.pdf<br>https://rigeo.org/view-artical/?s_id=2308<br>**Viev Article:**<br>https://rigeo.org/submitamenuscript/index.php/submission/article/view/2308/1780. | | | | | | | | |
| Punimi si autor i parë: **Phd.C. Kastriote Vlahna / Prof. Dr. Hajredin Kuçi / Mr.Sc. Argona Kuçi;**<br>**Titulli i punimit:**<br>Acquisition Of the Right of Real Servitude Over Immovable Property According to The Legislation in Kosovo with A Comparative View with Some Legislations of European Countries.<br>**Publication:**<br>Journal of Positive School Psychology;**ISSN: 2717-7564;**<br>Publication date: Vol. 6 No. 4 (2022); Pages: 11675 – 11682.<br>**Index: Scopus,** Ebsco, Wordcat, google scholar Eric, Index Copernicus, Informit I.<br>**Scientific journal link:**<br>https://journalppw.com/index.php/jpsp/issue/view/31<br>**Viev Article:**<br>https://journalppw.com/index.php/jpsp/article/view/7083/4626. | | P<br>O | PO | | PO | 1 | | PO |
| Punimi si autor i parë**: Phd.C. Kastriote Vlahna/ Prof. Dr. Hajredin Kuçi;**<br>**Titulli i punimit:**<br>**EU Law, as an Autinomous Legal System;**<br>**Publication:**<br>Journal Information:<br>Central Asian Journal of Innovations on Tourism Management and Finance (ISSN: 2660-454X).<br>Publication date: 2022/5/26; Volume: 3; Issue: 5; Pages: 80-87.<br>**Index:** Doaj, WordCat, GoogleScholar, etc.<br>**Scientific journal link:**<br>https://cajitmf.centralasianstudies.org/index.php/CAJITMF/article/view/237/240<br>**Viev Article:**<br>https://cajitmf.centralasianstudies.org/index.php/CAJITMF/article. | | | | PO | PO | 1 | | PO |
| Punimi si autor i parë: **Phd.C. Kastriote Vlahna / Prof. Dr. Hajredin Kuçi**<br>**Titulli i punimit:**<br>Extradition under Domestic and International Law<br>**Publication:** | | | | PO | PO | 1 | | PO |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Journal Information:<br>Central Asian Journal of Innovations on Tourism Management and Finance (ISSN: 2660-454X).<br>Publication date: 2022/5/17; Volume: 3; Issue: 5; Pages: 3-13<br>**Index:** Doaj, WordCat, GoogleScholar, etc.<br>**Scientific journal link:**<br>https://cajitmf.centralasianstudies.org/index.php/CAJITMF/article/view/225<br>**Viev Article:**<br>https://cajitmf.centralasianstudies.org/index.php/CAJITMF/article/view/225/223 | | | | | | | | |
| Punimi si autor i parë:**Phd.C. Kastriote Vlahna / Mr.Sc. Argona Kuçi**<br><br>**Titulli i punimit:**<br>Branches of Private Law According to Positive Law in Kosovo<br>**Publication:**<br>Journal Information:<br>**International Journal of Formal Education ISSN: 2720-6874;** Publication date: 2022/6/20; International Journal of Formal Education; Volume: 1; Issue: 6; Pages: 13-25;<br>**Index:** WordCat, GoogleScholar etc.<br>**Scientific journal link:**<br>http://journals.academiczone.net/index.php/ijfe/article/view/98/74<br>**Viev Article:**<br>http://journals.academiczone.net/index.php/ijfe/article/view/98 | | | | | PO | 1 | | PO |
